

Lajtmotivi i Diakonisë Immanuel Albertinen Diakonie

Lajtmotivi i Diakonisë Immanuel Albertinen Diakonie përshkruan imazhin tonë dhe parimet tona themelore. Ai jep orientimin për veprimtarinë tonë profesionale dhe bënë të qarta aspiratat e ndërmarrësisë tonë dhe punonjësve tanë. Ai na tregon çka është e rëndësishme në bashkëveprimin me të gjithë njerëzit, me të cilët ne kemi të bëjmë. Mënyra se si ne e jetojmë këtë lajtmotiv në punën tonë të përditshme, është njësia me të cilën ne matemi.

“Gjithçka, pra, që ju dëshironi t’ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre.”

Bibla: Mateu 7.12

Ne e jetojmë dashurinë për njëri-tjetrin.

- Ne veprojmë në të mirë të njerëzve dhe për një botë sa më të drejtë.
- Ne udhëhiqemi nga botëkuptimi i krishterë mbi njeriun dhe botën.
- Ne na bashkon dhe na lidh me njëri-tjetrin fryma e bamirësisë ndaj tjetrit.

Ne vendosim njeriun në qendër të vëmendjes.

- Ne i mbështesim dhe i përcjellim njerëzit në çdo fazë të jetës së tyre.
- Ne respektojmë dinjitetin dhe autonomin e çdo njeriu.
- Ne i trajtojmë të gjithë me respekt dhe vlerësim.
- Ne jemi të vetëdijshëm dhe të kujdesshëm ndaj mirëqenies së tjetrit dhe tonë.

Ne veprojmë së bashku.

- Ne jemi pjesë e një komuniteti dhe kontribuojmë në suksesin e misionit të diakonisë sonë.
- Ne e vlerësojmë njëri-tjetrin në larmishmërinë dhe ndryshueshmërinë tonë.
- Ne punojmë së bashku krahas krahas nën frymën e mirëbesimit.
- Ne nderojmë traditat tona dhe mbetemi të hapur ndaj risive.

Ne ndërthurim diakoninë (bamirësinë sociale) me efikasitetin ekonomik.

- Vepra diakonike është misioni ynë.
- Suksesin tonë ekonomik ne e vendosim në shërbim të bamirësisë ndaj njerëzve.
- Ne dëshirojmë të përmirësohemi në vijimësi dhe në të njëjtën kohë pranojmë limitet tona njerëzore.
- Ne synojmë përtëritshmërinë dhe përdorimin me përgjegjshmëri të burimeve natyrore.